




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0/DPK	Nr. Prot.	01-177/16
Dep.		Prot. no.	
Nr. flet.		Data	18.01.2016
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages		Data	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.01.2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4672-15 për z.Ukshin Rrecaj–Menaxher Rajonal në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), për shkak se nuk ka prova që dëshmojnë për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur pas një pyetje të gazetarit “Drejtësia në Kosovë”, me nr. AKK-03-02-4672-15, për Zyrtarin e lartë, z.Ukshin Rrecaj–Menaxher Regjional në Administratën Tatimore të Kosovës, është trajtuar në bazë të konstatimit të gazetarit që e ka dërguar në formë pyetje në AKK, se a paraqet konflikt interesi ushtrimi i funksionit të Anëtarit të KRM “Uniteti” në Mitrovicë dhe funksioni i Menaxherit Rajonal në Administratën Tatimore të Kosovës.

Meqenëse kjo ka qenë vetëm pyetje e gazetarit, ajo është dashtë së pari të verifikohet. Dhe në bisedën e parë telefonike me z.Rrecaj ai na ka deklaruar se ka kohë që ka heq dorë nga funksioni i Anëtarit të Bordit të KRM “Unitetit”.

Për shkak të kompletimit dhe argumentimit të lëndës, kemi kërkuar nga z.Rrecaj që të na dërgojë tekstin e dorëheqjes, me vulë dhe protokol. Me 12.01.2016 z.Rrecaj në AKK, ka dërguar një kopje të shkresës së dt.18.10.2015 në të cilën shihet se ai ka dhënë dorëheqje nga të qenurit Anëtar i Bordit të KRM “Uniteti”. Në fakt z.Rrecaj ka deklaruar se ai edhe më herët nuk kishte marr pjesë në takimet e KRM “Uniteti”, por me shkrim Dorëheqjen e ka ofruar në këtë datë.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

